



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2023

Nëntor 2022



©Akademia e Drejtësisë 2022, Të gjitha të drejtat e rezervuara Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Plani i punës dhe i Performancës është miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë me datën 22.11.2022

Tabela e përmbajtjes

1. Lista e shkurtesave	6
2. Hyrje	7
3. Përmbushja e Planit për vitin 2022 dhe sfidat gjatë realizimit të tij	7
Rëndësia e Planit të Punës për vitin 2023	9
Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë	9
Organet e Akademisë së Drejtësisë.....	10
Këshilli Drejtues	10
Këshilli Programor.....	11
Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.....	11
Objektivat e Planit të Punës për vitin 2023.....	11
Objekti I: Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar - PTF	12
1.1 Zbatimin e trajnimit fillestar për 48 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së IX	13
1.2 Zbatimin e trajnimit fillestar për 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX	13
1.3 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e X të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.....	14
Objekti II: Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor - (PTV).....	15
2.1 Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve sipas vlerësimit të nevojave të dala nga kërkesa e dokumenteve strategjike që kanë impakt për gjyqësorin	16
2.2 Zbatimi i trajnimeve të specializuara	18
2.3 Zbatimi i trajnimeve sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.....	19
2.4 Realizimi i trajnimeve përmes tryezave për adresimin e problemeve praktike dhe çështjeve nga praktika gjyqësore.....	19
2.5 Trajnimet e detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK	20
2.6 Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive	20
2.7 Trajnimet për bashkëpunëtorët profesional,zyrtarët ligjor si dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	20
2.8 Ofrimi i trajnimeve sipas kërkesës së institucioneve të profesioneve të lira ligjore	21
Objekti III: Zhvillimi i programeve trajnuese përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese.....	21
3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë	22

3.2 Hulumtimi i praktikës gjyqësore në çështjet penale	22
3.3 Zhvillimi dhe avancimi i veprimtarisë botuese.....	22
Objektivi IV: Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese	23
4.1 Zbatimi i Trajnimeve për Trajnues (TiT).....	24
4.2 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	21
Objektivi V: Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.	24
Objektivi VI: Transparenca dhe marrëdhënia me publikun.....	26
Objektivi VII: rishikimi i akteve nënligjore dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe financa.....	26
Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së	29

1. Lista e shkurtesave

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

DAF – Departamenti i Administratës dhe Financave

EIFL - Electronic Information for Libraries

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PST-Programi i Specializuar i Trajnimit

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

2. Hyrje

Bazuar në mandatin e përcaktuar me ligj, Akademia e Drejtësisë është e angazhuar në fuqizimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve përfshirë edhe kapacitetet për profesionistët tjerë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Në përmbushje të mandatit të saj me ligj është përgatitur Plani i Punës dhe Performancës për vitin 2023, në të cilin plan do të paraqiten objektivat dhe veprimet konkrete në arritjen e këtyre objektivave për këtë vit.

Plani i Punës dhe i Performancës ka për qëllim të definojë saktë aktivitetet në zbatim të programeve të AD-së duke marrë në konsideratë kapacitetet dhe resurset që ka ky institucion, përvojën dhe praktikën më të mirë si dhe zhvillimet e reja.

Plani i Punës dhe Performancës është hartuar në pajtim me prioritetet nacionale në fushën e drejtësisë, veçanërisht me Strategjinë për Sundimin e Ligjit dhe në detaje do të ofrojë aktivitetet që do të realizohen në ngritje të kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë këtu edhe të profesionistëve tjerë ligjor. Përmes këtij dokumenti janë përcaktuar njësitë përgjegjëse, veprimet që do të ndërmerren për realizimin e tyre duke përfshirë periudhën kohore si dhe treguesit apo indikatorët që do të mundësojnë matjen dhe monitorimin e përmbushjes së rezultateve.

Në funksion të realizimit të Planit të Punës dhe Performancës, AD ka përgatit Planin e veprimit për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara i cili është pjesë e këtij dokumenti.

3. Përmbushja e Planit për vitin 2022 dhe sfidat gjatë realizimit të tij

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2022 është përmbushur konform objektivave të përcaktuara për këtë vit. Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme për vitin 2022 kanë qenë të planifikuara 113 aktivitete trajnuese për gjyqtarë, prokurorë, stafin administrativ dhe profesionet e lira, përfshirë këtu edhe Trajnimet e trajnuesve si dhe mësimi në distancë. Si rezultat i ndryshimeve legjislative veçanërisht për Kodin e Procedurës Penale si dhe kërkesave tjera nga projektet me donatorë deri me 1 nëntor të këtij viti janë realizuar gjithsejtë 150 aktivitete trajnuese, ndërkaq deri në fund të vitit janë për realizim edhe rreth 28 aktivitete tjera. Përveç aktiviteteve të planifikuara në formë të tryezave për unifikim të praktikës në të gjitha fushat, programet e specializuara për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, trajnimet për të drejtat e njeriut, drejtësinë për fëmijë, dhunën në familje si dhe trajnimet nga aspekti interdisiplinar janë realizuar edhe trajnimet në fushën e ndërmjetësimit, dhunës në familje, krimit kibernetik të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve

nga departamentet përkatëse. Gjithashtu, Strategjia për sundimin e Ligjit ka ndikuar në intensifikimin e një numri të konsiderueshëm të aktiviteteve të AD-së.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare nga muaji korrik filloj trajnimi fillestar për 48 gjyqtarët dhe 6 prokurorët e sapo emëruar të cilët për Akademinë e Drejtësisë përbëjnë gjeneratën e IX dhe që nga atëherë janë zhvilluar sesionet trajnuese konform programit trajnues për këtë vit. Realizimi i trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar është realizuar në dy grupe, njëri grup 18 gjyqtarë dhe tjetri 30 gjyqtarë, ndërsa trajnimi për 6 prokurorët është realizuar konform programit për prokuror dhe ndaras nga grupet e gjyqtareve.

Përveç zbatimit të trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë janë zbatuar edhe një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve trajnuese sipas kurrikulës trajnuese për bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive. Gjatë këtij viti janë realizuar aktivitetet trajnuese nga moduli-aspekti penal material dhe procedural për të vazhduar më pas në vitin në vijim edhe me aspektin civil material dhe procedural. Janë realizuar edhe aktivitetet trajnuese sipas planifikimit për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe për profesionistët tjerë ligjor përkatësisht për përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave, ndërmjetësuesit, si dhe për zyrtarët e ndihmës juridike falas.

Trajnimet deri në muajin mars janë realizuar përmes platformës online, ZOOM ndërkaq pas kësaj periudhe me pjesëmarrje fizike meqenëse është vlerësuar se janë evituar shkaqet për pandeminë COVID 19.

Në kuadrin e vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë është zhvilluar procesi konform planifikimit. Janë përfshirë gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke i konsumuar gjitha burimet e informacionit përfshirë edhe rekomandimet që dalin nga dokumentet strategjike të vendit. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti i cili ofron analizën e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2023, ecurinë e procesit, metodologjinë si dhe rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces.

Në fushën e publikimeve janë realizuar buletinët dhe modulet trajnuese sipas planifikimit ndërkaq janë pezulluar nxjerrja e revistave për shkak të paqartësive ligjore dhe pengesave tjera për të cilat AD i ka adresuar edhe në projektligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Në sektorin e financave janë realizuar të gjitha pagesat me kohë për obligimet që kanë rrjedh gjatë këtij viti. Edhe pse ka pasur vështirësi dhe vonesa megjithatë plani i prokurimit është realizuar në përgjithësi.

Gjatë vitit 2022, Akademia e Drejtësisë është përballë edhe me vështirësi veçanërisht në koordinimin e programeve dhe trajnuesve meqë krahas kërkesës së madhe për trajnime të vazhdueshme pothuajse paralelisht ka filluar me programin e trajnimit fillestar për 48 gjyqtarët dhe 6 prokurorët e sapo emëruar

të gjeneratës së IX. Shtuar kësaj edhe zhvendosja e Akademisë së Drejtësisë në lokacionin e ri meqë objekti me qira në të cilin Akademia ka ushtruar veprimtarinë e saj është kërkuar të lirohet. Në anën tjetër objekti i saj që është në ndërtim e sipër nuk është përfunduar sipas kontratës për shkak të pengesave që kanë dalë gjatë procesit të ndërtimit. Me gjithë këto vështirësi është arritë përzgjedhja e objektit dhe funksionalizimi i tij pa cenuar rrjedhën e programeve dhe aktiviteteve të saj.

Vizioni dhe misioni

Akademia e Drejtësisë është institucion shtetëror i edukimit dhe aftësimin, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, faktor kyq për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që duhet të gëzoj besimin e publikut.

Akademia e Drejtësisë ofron trajnime cilësore për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, harton analiza, zhvillon hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe standardet e mira ndërkombëtare.

Rëndësia e Planit të Punës për vitin 2023

Plani i Punës dhe i Performancës është instrument thelbësor për Akademinë e Drejtësisë dhe kërkesë nga dispozitat e nenit 3 dhe 4 të Ligjit nr. 05/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura si dhe Rregullores nr. 3/2020 për performancën e agjencive.

Pra, është dokument bazë përmes të cilit zbatohet programi trajnues dhe njëkohësisht orienton punën e secilës njësi brenda institucionit. Ky dokument gjithashtu shfaqë resurset brenda institucionit të cilat duhet të angazhohen, proceset që duhet zhvilluar dhe hapat e mëtutjeshëm deri në arritjen e rezultateve.

Për përmbushjen e këtij plani AD do të angazhohet në menaxhimin e punës dhe bashkërendimin e aktiviteteve në mes programeve dhe shërbimeve tjera që ofron sipas ligjit si dhe në koordinimin me institucionet dhe përfituesit e saj sipas ligjit. Gjithashtu do të angazhohet që në mënyrë sistematike të përcjellë të arriturat e përcaktuara në këtë plan.

Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L -095 për AD-në, si dhe me plotësim Ligjit nr. 08/L-063, kapitulli IV për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-095 për

Akademinë e Drejtësisë, Akademia themelohet si institucion publik i pavarur e cila si funksion kryesor ka ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira përmes zbatimit të trajnimeve dhe zhvillimit të veprimtarisë botuese dhe materialeve tjera ligjore.

Vija llogaridhënëse e AD-së sipas *Ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura* është te Këshilli Drejtues i saj. Prandaj, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, AD do të rishikoj aktet nënligjore si në vijim:

- Rregullore Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë, dhe plotësim ndryshimet.

Ndërkaq planifikohen të rishikohen edhe aktet tjera nënligjore si në vijim:

- Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 07/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar;
- Rregullorja Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;

Organet e Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues si organ më i lartë i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2023 do të fokusohet në shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve si në vijim:

- Raporti vjetor për vitin 2022
- Listën e trajnuesve të përkohshëm
- Listën e mentorëve
- Procedurat dhe Standardet për publikim

- Projekt buxhetin e Akademisë së Drejtësisë
- Formimin e komisioneve për revistat e AD-së dhe komisione tjera tjera që dalin sipas nevojës për funksionimin më të mirë të AD-së;
- Kërkesat e KKG-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që janë në proces të rekrutimit;
- Programin Trajnues dhe Planin e Performancës për vitin 2024 si dhe çështje tjera që dalin gjatë vitit 2023.

Këshilli Programor

Këshilli Programor si organ profesional për vitin 2023 do të angazhohet për të siguruar cilësi për programet trajnuese dhe trajnimet e ofruara. Lidhur me këtë do të fokusohet në çështjet si në vijim:

- Hartimin e programit trajnues për vitin 2024
- Shqyrtimin e listës së trajnuesve dhe mentorëve dhe mendim për listën e trajnuesve potencial për Këshillin Drejtues
- Sigurimin e kualitetit të programeve trajnuese përmes orientimit të metodave dhe teknikave trajnuese si dhe do të
- Përcjellë e realizimin e programeve dhe suksesin e tyre.

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë do të angazhohet në prioritet si në vijim:

- Përfaqësimin e Akademisë në institucione vendore dhe ndërkombëtare;
- Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- Do të siguroj zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues
- Do të propozoj projektbuxhetin vjetor të Akademisë;
- Do të propozoj Planin e punës dhe të Performancës si dhe Programin trajnues të Akademisë për vitin 2024
- Do të propozoj listën e trajnerëve për miratim nga Këshilli Drejtues dhe nga lista do të caktoj trajnuesit për zbatim të programit;
- Do të Menaxhoj me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- Do të propozoj Projekt Rregulloret.

Objektivat e Planit të Punës për vitin 2023

- Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar - PTF.

- Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionisteve të tjerë ligjor-PTV;
- Sipas kërkesës së institucioneve ofrimin e trajnimeve për profesionet të lira;
- Zhvillimi i programeve trajnuese, përmes analizave, hulumtime si dhe veprimtarisë botuese;
- Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese
- Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor dhe ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.
- Transparenca dhe marrëdhënia me publikun
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve të departamentit për administratë dhe financa

Objektivi I: Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar - PTF

Bazuar në Programin e Trajnimit Fillestar për gjeneratën e IX-të (2022-2023) të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar do të vazhdojë realizimi i sesioneve trajnuese për 48 gjyqtarët dhe 6 prokurorët e kësaj gjenerate. Gjyqtarët do të vazhdojnë sesionet e trajnimit teorik në 5 ditë e javës deri në përmbushjen e moduleve të planifikuara për këtë gjeneratë dhe më pas do të vazhdojnë me sesionet e trajnimit praktik në gjykatat ku janë të emëruar. Prokurorët do të vazhdojnë paralelisht sesionet e trajnimit teorik me sesionet e trajnimit praktik, pra dy ditë të javës sesionet e trajnimit teorik ndërkaq tre ditë tjera sesionet e trajnimit praktik në prokuroritë ku janë të emëruar.

Përderisa procesi i rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj ka filluar nga KGJK dhe KPK, Akademia e Drejtësisë siç është e përcaktuar me ligj do të angazhohet në hartimin/përditësimin e programit dhe zbatimin e trajnime fillestare edhe për këtë gjeneratë. Për AD-në, gjyqtarët dhe prokurorët e rinj të cilët i kalojnë gjitha fazat e rekrutimit me sukses dhe si përfundim dekretohen në pozitat përkatëse, shënojnë gjeneratën e X (dhjetë).

Programi i Trajnimit Fillestar për vitin 2023, do të fokusohet në objektivat specifike si në vijim:

1. Zbatimin e trajnimit fillestar për 48 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së IX (trajnimi teorik në AD dhe trajnimin praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë).
2. Zbatimin e trajnimit fillestar për 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX (trajnimi teorik në Akademi të Drejtësisë dhe trajnimin praktik në prokuroritë përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit prokurorë)
3. Zbatimin e trajnimeve praktike për të 48 gjyqtarët dhe 6 prokurorët e sapo

- emëruar në institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe jashtë gjyqësore;
4. Zhvillimin dhe zbatimin e programeve trajnuese për gjeneratën e X të gjyqtarëve (37) dhe (22) prokurorëve të rinj.

1.1 Zbatimin e trajnimit fillestar për 48 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së IX

Trajnimi fillestar për gjyqtarë ka filluar me 15 korrik 2022 për 48 gjyqtarë të cilët kanë kaluar procesin e dekretimit nga presidentja. Deri në muajin gusht këtij programi i janë nënshtruar 48 gjyqtarët e sapo emëruar, ndërkaq pas kësaj periudhe një nga gjyqtarët për shkak të pushimit të lehonisë e ka ndërprerë trajnimin fillestar. Në kuadrin e trajnimeve fillestare për gjyqtarë, fillimisht do të realizohen sesionet e trajnimit teorik sipas moduleve trajnuese të planifikuara për këtë gjeneratë. Trajnimet do të vazhdojnë të realizohen në dy grupe sikurse gjatë vitit 2022 meqenëse numri prej 48 personave në një sallë është vlerësuar se nuk ofron komoditet dhe njëkohësisht cilësi dhe efekt të trajnimit. Për shkak edhe të koordinimit të trajnuesve, të dy grupet gjatë vitit 2022 kanë filluar me module të ndryshme dhe me disa prej tyre edhe module të njëjta. Programi sipas kalendarit të vitit 2023 do të vazhdojë të realizohet në 5 ditët e javës në modulet: E drejta civile ekonomike dhe administrative, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale si dhe Legjislacioni dhe Shkathtësitë Plotësuese deri në fund të muajit janar 2023.

Me përfundimin e moduleve trajnuese do të vazhdohet me sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse i cili do të filloj nga fundi i muajit janar dhe do të zgjasë deri në javën e dytë të muajit gusht 2023. Gjatë kësaj periudhe angazhohen mentorë nga radhët e gjyqtarëve me përvojë të cilët do të mentorojnë pjesën praktike të këtij programi. Mentorët në baza javore do të mbajnë të informuar Akademinë e Drejtësisë për zhvillimet dhe rezultatet e trajnimit praktik dhe në këtë formë do të punohet në arritjen objektivave dhe zbatimin me sukses të këtij trajnimi.

Në kuadrin e trajnimit praktik, gjyqtarët e sapo emëruar do të vijojnë edhe trajnime në institucione jashtë gjyqësore.

Bazuar në strukturën e programit pas përfundimit të sesioneve të trajnimit teorik dhe praktik do të realizohet testi përfundimtar me rezultatet e të cilit përmbyllet programi fillestar për këtë gjeneratë.

1.2 Zbatimin e trajnimit fillestar për 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX

Në kuadër të trajnimeve fillestare për 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX, për 5 ditët e javës deri në muajin korrik 2023 do të vazhdojnë të realizohen paralelisht sesionet e trajnimit teorik (dy ditë) në modulet trajnuese Kodi i

Procedurës Penale, Rendi Juridik Kombëtarë dhe Ndërkombëtar, Kodi Penal, Shkathhtësitë Personale dhe Ndërpersonale si dhe Legjislacioni dhe Shkathhtësitë Plotësuese në Akademi të Drejtësisë dhe sesionet e trajnimit praktik (3 ditë) në prokuroritë ku janë të emëruar. Mentorët e prokurorëve do të zbatojnë mentorimin e prokurorëve gjatë trajnimit praktik dhe Akademinë e Drejtësisë në baza javore do ta mbajnë të informuar për rezultatet e në këtë mënyrë në arritjen objektivave dhe zbatimin me sukses të këtij trajnimi.

Në kuadrin e trajnimit praktik, prokurorët e sapo emëruar do të vijojnë edhe trajnime në institucione jashtë gjyqësore.

Bazuar në strukturën e programit pas përfundimit të sesioneve të trajnimit teorik dhe praktik do të realizohet testi përfundimtar me rezultatet e të cilit përmbyllet programi fillestar edhe për këtë gjeneratë.

1.3 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e X të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.

Akademia e Drejtësisë ka përcjellë procesin e rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj nga KGJK-së dhe KPK-së dhe në hap me këto zhvillime do të angazhohet në hartimin/përditësimin e programit fillestar në përputhje me ndryshimet e reja legjislative dhe në zbatimin e këtij programi konform rregullave dhe legjislacionit në fuqi. Sipas konkurseve të dy këshillave potencialisht do të jenë 37 gjyqtarë dhe 22 prokurorë të rinj të cilët pritet të dekretohen dhe të bëhen pjesë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Programi për këtë gjeneratë, do të përmbajë trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, duke përfshirë edhe Acuis Communautaire, KEDNJ dhe aktet e tjera ndërkombëtare si dhe kompetencën interdiscipinare.

Në kuadër të këtij programi për gjyqtarë të sapo emëruar do të realizohen trajnimet nga 6 modulet trajnuese ndërsa për prokurorë 5 module trajnuese duke përjashtuar modulën i cili trajton çështjet ligjore nga fusha civile, administrative dhe ekonomike.

Modulet që do të trajtohen gjenden si në vijim.

- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- E drejta civile administrative dhe ekonomike
- Shkathhtësitë personale dhe ndërdisiplinare
- Legjislacioni dhe shkathhtësitë plotësuese

Ngjashëm sikurse me gjeneratën paraprake, trajnimi do të përfshijë sesionet e trajnimit teorik dhe praktik, ndërkaq trajnimi do të fillojë së zbatuari sapo të

përfundoj procesi i dekretimit.

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të përcjellë zhvillimet në gjyqësor sa i përket proceseve të reja të rekrutimit dhe ti përgjigjet kërkesave për trajnime fillestare të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.

Objektivi II: Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor - (PTV)

Rritja e kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare e gjyqtarëve, prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial përmes trajnimeve të vazhdueshme është obligim ligjor që rezulton nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë. Plani i punës dhe i Performancës do të ketë në konsideratë zbatimin e Programit trajnues për vitin 2023.

Pra realizmi i aktiviteteve trajnuese që janë rezultati kërkesave nga te gjitha dokumentet strategjike, kërkesa nga fushat që janë me prioritet për KGJK dhe KPK e me theks te luftimi i krimit te organizuar dhe korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit, formave tjera te keqpërdorimit të detyrës zyrtare, dhuna në familje, aspekti i të drejtave të njeriut si dhe çështjet tjera që janë sfiduese të praktikës gjyqësore. Bazuar ne nevoja për realizimin e këtyre trajnimeve te cilat kane dale nga mekanizmat për vlerësim të nevojave trajnuese dhe të njëjtat janë dizajnuar për tu adresuar përmes tryezave me qëllim të diskutimit dhe avancimin e praktikës gjyqësore.

Prioritet i larte i AD mbetet vazhdimi i ofrimit të trajnimeve për gjyqtaret dhe stafin mbështetës të Gjykatës Komerciale, ndërsa trajnimet për të drejtat e njeriut, veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, risitë e Kodit të Procedurës Penale, dhe tema të ngjashme do të realizohen me donatoret dhe projektet mbështese.

Ngritja dhe avancimi i njohurive profesionale për bashkëpunëtorët profesional do të jenë prioritet edhe në vitin 2023, e posaçërisht zbatimi i trajnimeve sipas moduleve bazike në fushën penale dhe civile si dhe pjesëmarrja e tyre në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Stafit tjetër mbështetës i gjykatave dhe prokurorive po ashtu do të ketë trajnime që i përshtaten detyrave të punës, përvojës si dhe kompetencave specifike që ka secili prej tyre në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Vëmendje të veçantë do të kenë edhe profesionistët e tjerë ligjor, veçanërisht përmbauesit, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe jo vetëm.

Në këtë drejtim për vitin 2023, trajnimet e vazhdueshme do të fokusohen në objektivat dhe fushat specifike si në zhvillimin dhe zbatimin e tyre:

1. Trajnimet nga lëmia Penale
2. Trajnime nga Programet e Specializuara ne fushën Penale

3. Trajnimet nga lëmia civile
4. Trajnimet nga lëmia e drejtësisë për fëmijë
5. Trajnimet nga lëmia komerciale
6. Trajnimet nga lëmia administrative
7. Trajnimet ne lëmine e kundërvajtjeve
8. Trajnimet nga drejtësia kushtetuese
9. Trajnimet për KEDNJ
10. Trajnimet nga e Drejta e BE-së dhe e drejta ndërkombëtare
11. Trajnimet nga kompetenca interdisciplinare
12. Trajnimet bazike për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor
13. Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
14. Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive
15. Trajnimet për profesionet e tjera të lira
16. Trajnimet për trajnues

2.1 Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike që kanë impakt për gjyqësorin

Në kuadër të Planit të Punës dhe të Performancës së AD-së për vitin 2023 janë përfshirë masat dhe aktivitetet që janë prioritet sipas tri dokumenteve themelore strategjike që kërkojnë përmirësimin, respektivisht ngritjen e profesionalizmit të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësorë në Kosovë, e që janë të përmbledhura sikurse: Strategjia për sundimin e Ligjit, Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje, Programi Kombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këto dokumente janë rezultat i kërkesave edhe nga mekanizmat tjerë si PKZMSA dhe raporti i BE-së për Kosovën.

Strategjia për sundimin e ligjit 2021-2026 - kërkon rritjen e profesionalizmit dhe kompetencës së gjyqtarëve, prokurorëve si dhe stafit mbështetës për ngritjen e cilësisë së vënies së drejtësisë. Bazuar në gjetjet që kjo strategji i ka detektuar, Plani i Punës dhe i Performancës së AD-së për vitin 2023 do të përfshijë realizimin e aktiviteteve si në vijim:

- Ofrimin e trajnimeve për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës
- Trajnimi i gjyqtarëve dhe stafit mbështetës në fusha të specializuara komerciale.
- Sesione të rregullta të Trajnimit të Trajnerëve (TiT).
- Ofrimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për të gjithë anëtarët e rinj dhe të vjetër të KZR-së.
- Trajnimet të specializuara të mbështetjes për Komisionin e Vlerësimit të kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorëve (KP).
- Trajnimet për njësitë ekzistuese të verifikimit të KPK-së me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në verifikim.
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për konfiskimin e pasurisë

- Rishikimi i kurikulave për arsimim ligjor dhe inkorporimi i aftësive të të menduarit kritik
- Trajnime bashkëpunuese të sponsoruar në mes të PK, prokurorëve dhe gjyqtarëve për arsye të koordinimit më të mirë sa i përket të kuptuarit reciprok të kodeve dhe ligjeve relevante
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për stafin e ANJF-së, gjyqtarë dhe prokurorë
- Zbatimi i programeve të specializuara të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë në lidhje me natyrën gjinore të akteve të dhunshme ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, dhe zbatimin e Udhëzimeve për Dënime në Kosovë
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta tematike për profesionet e lira me gjykatësit, prokurorët, stafin mbështetës nga gjykatat dhe zyrat prokuroriale, me qëllim të bashkërendimit dhe bashkëpunimit të përmirësuar ndër-institucional në mes të MD, AD dhe odave përkatëse.
- Trajnime të specializuara kundër korrupsionit për të gjithë gjyqtarët e caktuar.
- Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për qëllim të interpretimit dhe zbatimit të njëjtë të nenit 430 të Kodit Penal dhe Ligjit për Deklarimin e Pasurive, si dhe për diferencimin e raportimit të rremë me falsifikim të dokumenteve.

Realizimi i disa nga aktivitetet sipas kësaj strategjie do të jenë sfiduese për AD-në pasi që janë shumë specifike se janë trajnime dedikuar komisioneve, organeve, veprimtaria e të cilëve është vlerësimi i performancës, verifikimi e çështje tjera që janë pjesë e punës së KGJK-së dhe KPK-së e për të cilat AD nuk ka pasur përvojë në këtë drejtim. Sidoqoftë AD do të angazhohet në tejkalimin e kësaj vështirësie përmes koordinimit dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe ekspertizës së jashtme.

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut-Plani i veprimit 2021-2023, po ashtu kërkon e rritjen e profesionalizmit dhe kompetencës së gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me fokus në lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjalizimin e gazetarëve në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës. Andaj edhe AD do të përfshijë aktivitetet si në vijim:

- Trajnim për procedurën penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore
- Trajnimin për rastet e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe ngacmimit seksual me një qasje të përqendruar nga viktimat
- Trajnimi për Protokollin e Stambollit për avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët, të cilët mund të përfshihen në çështje gjyqësore

- Trajnimi për mos diskriminimin
- Trajnimi për Sulmet ndaj gazetarëve
- Trajnimi për Krimet e urrejtjes
- Trajnimi për rastet që cenojnë të drejtat e personave të komunitetit (LGBTI)
- Trajnimi për praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut
- Trajnimi për Lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjalizimin e gazetarëve në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës;
- Trajnimi për ndarjen e pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit, alimentacioni, mbajtja financiare e bashkëshortit-es.

Ky dokument strategjik në Planin e veprimit 2021-2023 nuk përcakton numrin e sesioneve trajnuese që duhet të mbahen për standardet e të drejtave të njeriut në tematikat si më lartë por, kërkon që të trajnohen gjyqtarë dhe prokurorë me mundësi përfshirje edhe të zyrtareve që merren me të drejtat e njeriut dhe zyrtarëve për barazi gjinore.

Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 - gjithashtu kërkon rritjen e profesionalizmit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe përveç kësaj edhe në rastet kur përfshihen kryes me çrregullime mendore. Andaj, Plani i Punës dhe i Performancës së AD-së do të ketë prioritet realizimin e tyre. Bazuar në kërkesat që dalin nga ky dokument strategjik, 7 sesione trajnuese duhet të realizohen për dhunën në familje (aspekti penal dhe civil) si dhe 2 sesione trajnuese për rastet kur në procedurë përfshihen kryesit me çrregullime mendore.

2.2 Zbatimi i trajnimeve të specializuara

Në kuadrin e trajnimeve të specializuara do të realizohen 9 trajnime në çështjet si në vijim:

- PST për Krimin kibernetik
- PST për Shpëlarjen e parave dhe hetimin financiar
- PST për Prokurimin publik
- PST për Krimin e organizuar
- PST për Korrupsionin
- PST për Ekstremizmin, radikalizmin dhe terrorizmin
- PST për Dhunën në familje
- PST për Krimet e luftës
- PST për hartimin e akteve akuzuese nga Prokuroria Speciale

Këto trajnime do të realizohen në dy-tri sesione. Përfitues të këtyre trajnimeve do të jenë gjyqtarë dhe prokurorë nga departamenti për krime të rënda, departamentit special, bashkëpunëtor profesional nga gjykata dhe prokuroria – departamenti special si dhe ekspert nga PSRK. Gjithashtu do të përfshihen edhe zyrtarë tjerë ligjor të cilët në faza të caktuara janë pjesë e procedurës gjyqësore si: zyrtarë policor hetues, zyrtarë të NJIF, mbrojtës të viktimave si dhe zyrtarë nga institucione tjera që kanë fushëveprim luftimin e veprave përkatëse.

2.3 Zbatimi i trajnimeve sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Programi i trajnimeve të vazhdueshme do të ofrojë edhe trajnime tjera sipas kompetencave dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për të siguruar cilësi do të angazhohen trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe profesionistë tjerë ligjor me përvojë dhe performancë të shkëlqyer në fushën e zbatimit të ligjit. Trajnimet do të dizajnohen me target gjyqtarët dhe prokurorët kompetent dhe do të realizohen përmes metodologjisë së studimit të rasteve dhe metodave tjera trajnimit gjyqësor. Sipas përmbajtjes do të realizohen trajnime nga drejtësia penale, civile, drejtësia për të mitur, të drejtësia administrative, tregtare–komerciale, financiare, mbrojtën e mjedisit, bashkëpunimin ndërkombëtar, E Drejta Ndërkombëtare dhe e Bashkimi Evropian (BE), E drejta kushtetuese si dhe Kundërvajtëse. Po ashtu edhe trajnimet nga kompetenca ndërdisciplinore me theks te shkrimi dhe arsyetimi gjyqësor, etika profesionale¹, komunikimi, menaxhimi i stresit, shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim, evidenca penale, teknologjia informative si dhe menaxhimi i rasteve dhe fusha të tjera specifike.

2.4 Realizimi i trajnimeve përmes tryezave për adresimin e problemeve praktike dhe çështjeve nga praktika gjyqësore

Nga takimet me gjyqtarë, kryetare, trajnues etj ne lidhje me metodologjinë trajnuese, është vlerësuar se trajnimet e mbajtura sipas metodës ex catdre te ndryshohen dhe te realizohen nëpërmes tryezave. Gjate vitit 2022 AD ka realizuar një numër të trajnimeve në formën e tryezave dhe rezultatet kanë treguar se kjo metodologji është shume e përshtatshme për të ngritur dhe avancuar njohuritë e gjyqtareve dhe prokurorëve në fusha dhe tema të caktuara. Andaj edhe për vitin 2023 AD me do të realizojë tryezat me gjyqtarë dhe prokurorë në të cilat do të adresohen çështje të ndryshme ligjore në fushën penale, civile, administrative. Këto tryeza do të moderohen dhe udhëhiqen nga gjyqtarë dhe prokurorë të departamenteve të nivelit të Apelit dhe nivelit Suprem me të vetmin qëllim që çështjet ligjore për të cilat praktika gjyqësore ka vështirësi dhe zvarritje në zgjidhjen ligjore të ofrohen zgjidhjet adekuate konform ligjeve në fuqi. Tryezat konsiderohen si më efikase edhe për faktin se

¹ Sipas kërkesave të KGJK-së dhe KPK-së

në fund planifikohen konkluzionet e tryezës të cilat më pas kanë impakt në unifikimin e praktikës, hartimin e doracakëve, udhëzuesve etj.

2.5 Trajnimet e detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK

Akademia e Drejtësisë do të jetë e angazhuar në zbatimin e trajnimeve të detyrueshme që janë rezultat i obligimeve ligjore dhe akteve nën ligjore të KGJK-së dhe KPK-së. Për vitin 2023 bazuar në nevojat e Këshillit Prokurorial për trajnime në fushën e etikës profesionale në koordinim me këtë institucion si dhe me kryeprokrorët e prokurorive do të realizojë trajnime në këtë fushë dhe do të përfshijë gjithë prokrorët që e kanë obligim sipas rregullores së KPK-së. Gjithashtu, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet që të njejtën ta bëjë edhe me KGJK-në nëse vendosin të vazhdojnë me trajnime të detyrueshme në çështjet etike ose edhe çështje tjera për gjyqtarë.

2.6 Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive

Avancimi i aftësive menaxheriale për pozitat udhëheqëse në gjykata dhe prokurori ka qenë pjesë integrale e Programit trajnues e gjithashtu edhe kërkesë e Strategjisë për sundimin e Ligjit. Në funksion të kësaj AD është angazhuar në zbatimin e këtij trajnimi përmes ekspertizës nga jashtë pasi ka pasur mungesë të ekspertizës vendore. Përkundër përpjekjeve nuk është arritur sigurimi i ekspertizës në këtë fushë. Zbatimi i këtij trajnimi do të mbetet prioritet edhe më tej për të krijuar një program të qëndrueshëm duke përfshirë edhe ngritje e kapaciteteve trajnuese në këtë fushë për vitin 2023

2.7 Trajnimet për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor si dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë me zbatimin e trajnimeve sipas moduleve të trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor. Gjatë vitit 2022 janë realizuar trajnimet për aspektin penal material dhe procedural, ndërkaq gjatë vitit 2023 do të vazhdohet me trajnimet për aspektin civil material dhe procedural.

Fokusi thelbësor do të jetë në përfshirjen e gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në gjykata dhe prokurori edhe trajnimet te tjera sipas kërkesave dhe nevojave të parashtrua në AD.

Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë obligim ligjor për Akademinë e Drejtësisë dhe në këtë drejtim, Akademia është angazhuar në zhvillimin e programeve trajnuese sipas profileve dhe detyrave të punës. Bazuar në Programin trajnues për vitin 2023, Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në zbatimin e trajnimeve sipas moduleve që përfshijnë aspektin profesional dhe interdisiplinar.

2.8 Ofrimi i trajnimeve sipas kërkesës së institucioneve të profesioneve të lira ligjore

Si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa nga institucionet e profesioneve të lira, shtuar kësaj edhe kërkesat që dalin nga Strategjia për sundimin e ligjit dhe dokumentet tjera strategjike për gjyqësorin, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të ofrojë trajnime për përmbartuesit privat, zyrtarët e ANJIF, mbrojtësit e viktimave, ndërmjetësuesit si dhe sipas kërkesave dhe nevojave për trajnime të avokatëve shtetëror. Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të mundësoj pjesëmarrjen e tyre në trajnimet e vazhdueshme bashkë me gjyqtarët dhe prokurorët. Për numrin e trajnimeve dhe detajet tjera duhet referuar Programit Trajnues për vitin 2023.

2.9 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2022 ka investuar në ndryshimin e platformës së mësimin në distancë dhe nga platforma ILIAS është kaluar në platformën MOODLE e cila është vlerësuar si më funksionale për përdorim. Kjo kërkesë, përveç nga rekomandimet e bashkëpunëtorëve të AD-së, ka ardhur edhe nga përfituesit e platformës.

Meqenëse stafi i AD ende nuk është i familjarizuar me platformën MOODLE, dhe kërkon kohë që të bëhet trajnimi i stafit nga ekspert ndërkombëtarë, atëherë AD synon që gjatë vitit 2023 të vazhdojë me dy (2) platformat (ILIAS dhe MOODLE) paralelisht në ofrimin e trajnimeve për përfituesit e saj.

Sipas kërkesës nga KGJK dhe KPK, AD do të ofrojë online kurset e saj të zhvilluara më parë në platformën e vjetër ILIAS, dhe njëkohësisht do të bëhet edhe funksionalizimi dhe përditësimi i kurseve në platformën MOODLE.

Me qëllim të ofrimit të trajnimeve sa më profesionale, AD, përveç platformave të saj elektronike, është në bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me Këshillin e Evropës, në ofrimin e trajnimeve në platformën HELP të KiE. Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar dy kurse trajnuese në këtë platformë kurse gjatë vitit 2023, synohet që përveç këtyre kurseve të zhvillohet edhe një kurs tjetër me temë: “Qasja e grave në drejtësi”. Duhet theksuar se të gjitha këto kurse do mundësohen si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë serbe.

Objektivi III: Zhvillimi i programeve trajnuese përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese

Rritja e kapaciteteve analitike dhe hulumtuese është thelbësore për programe trajnuese cilësore dhe krijimin e botimeve të reja në fushën juridike me theks të modulet trajnuese, doracakët, udhëzuesit dhe format tjera që lehtësojnë punën praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve si përfitues kryesor sipas Ligjit për

Akademisë e Drejtësisë. Në këtë vështrim programi i PHP-së për vitin 2023 do të orientohet në këto objektiva specifike:

- 3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2024
- 3.2 Hulumtimi i praktikës gjyqësore në çështjet penale
- 3.3 Zhvillimin dhe avancimin e veprimtarisë botuese
- 3.4 Zbatimi i masave dhe politikave integruese

3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë

Vlerësimi i nevojave trajnuese është një proces tejet i veçantë i cili synon analizën e burimeve të ndryshme të informacionit me të vetmin qëllim që programi trajnues të adresoj problemet praktike dhe përmes kësaj edhe fuqizimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve në gjykata. Në funksion të kësaj, Programi i PHP-së do të angazhohet në zbatimin e mekanizmave për vlerësim dhe të bëjë analiza dhe vlerësime sipas standardeve duke përcjellë zhvillimet në gjyqësor gjatë gjithë vitit.

Në kuadër të këtij procesi do të përfshihen gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në identifikimin e vështirësive dhe problemeve praktike. Do të konsultohen përfaqësuesit e gjitha gjykatave dhe prokurorive dhe udhëheqësit e degëve. Të gjitha resurset brenda programit do të angazhohen në analiza dhe hulumtime, në mbledhje të burimeve dhe informacioneve dhe në pajtim me strategjitë dhe prioritetet e gjyqësorit do të zhvillohet kurrikula trajnuese vjetore.

3.2 Hulumtimi i praktikës gjyqësore në çështjet penale

Programi i PHP-së do të angazhohet edhe në hulumtimin e praktikës gjyqësore të gjykatave themelore, përkatësisht të divizionit penal. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është identifikimi i shkeljeve më të shpeshta të natyrës materiale dhe procedurale të cilat më pastaj rezultojnë me vendime jo të drejta ose të ligjshme e gjithashtu edhe me kthimin e tyre në rishqyrtim. Për të realizuar këtë hulumtim do të nevojitet analiza e aktgjykimeve të nxjerra nga Gjykatat Themelore si dhe vendimet e Gjykatës së Apelit. Gjetjet nga hulumtimet do të jenë një impakt i mirë për krijimin e përmbledhjes ose një materiali udhëzues për mënyrën e zbatimit të dispozitave materiale dhe procedurale në çështjet përkatëse.

3.3 Zhvillimi dhe avancimi i veprimtarisë botuese

Programi i PHP-së do të angazhohet në zhvillimin dhe avancimin e veprimtarisë botuese përmes adoptimit të procedurave dhe standardeve për publikim.

Gjithashtu programi do të orientohet në furnizimin me sofwer ose platformë për detektim të plaxhiaturës, vegël kjo e cila përmirëson cilësinë e botimeve, përkatësisht moduleve dhe formave tjera të publikimeve të AD-së. Realizimi i aktiviteteve përkatëse do të bëhet nëse tejkalohen mungesat e kuadrit ligjor respektivisht zhvillimi i procedurave standarde dhe kritereve për publikim, krijimi të organit, përkatësisht komisionit për vlerësimin e punimeve, moduleve trajnuese si dhe nëse AD-së i aprovohet buxheti sipas planifikimit.

AD ushtron veprimtarinë e saj përkohësisht nuk e arsyeton koston financiare. Sidoqoftë, Akademia e Drejtësisë do të përcjellë zhvillimet në këtë fushë dhe nëse rritet kërkesa për burimet që i ka në dispozicion do të mundësoj funksionalizimin e më këtë edhe ofrimin e burimeve ligjore. Gjithashtu për çdo zhvillim apo edhe burime të reja shfrytëzimi i tyre përmes ofrimit të qasjes dhe ofrimit të linqeve për formatin elektronik.

3.4 Zbatimi i masave dhe politikave integruese

Akademia e Drejtësisë do të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat vendore në zbatimin e masave dhe aktiviteteve në përmbushje të agjendës evropiane. Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në zbatimin e masave të përcaktuara për vitin 2023 të cilat reflektojnë kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe mekanizmave tjerë euro integruar. Në këtë drejtim me mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë, do të bashkëpunoj edhe më tutje duke ofruar raporte të veçanta periodike dhe të dhënave tjera që kërkohen nga misionet e vlerësimit nga mekanizmat përkatës.

Objektivi IV: Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese

Avancimi i metodologjisë trajnuese ishte dhe mbetet prioritet për AD-në. Kjo komponentë do të realizohet përmes:

4.1 Zhvillimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë

Akademia e Drejtësisë, me qëllim të përgatitjes së një kuadri të qëndrueshëm trajnuesish nga fusha penale, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, gjatë muajit Korrik 2022 ka realizuar punëtorinë e certifikimit të trajnuesve nga fusha penale. Nga kjo punëtori rezultoi të certifikohen **16** trajnues nga fusha penale, që përfshijnë Gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë nga Ambasada Amerikane si dhe trajnues nga AD. Qëllimi dhe synimi i AD është që këta 16 trajnues, të shërbejnë si model dhe si trajnues për të gjithë trajnuesit tjerë nga fusha penale, duke vënë themelet e para për krijimin e Programit të përhershëm për Trajnues. Ky proces pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023, tani me trajnerët e fushës civile, proces i cili do të bëhet në bashkëpunim dhe koordinim me Ambasadën Amerikane, zyrën e OPDAT.

4.2 Zbatimi i Trajnimeve për Trajnues (TiT)

Trajnimet e Trajnuesve do të vazhdojnë të jenë rezultat i bashkëpunimit me projektet dhe donatorët e AD-së. Në këtë komponentë Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunime të shumta me Institucione dhe organizata të ndryshme si: Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, dhe gjitha projektet e saj, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadën Britaneze, OJQ të ndryshme që operojnë në vendin tonë.

Gjatë vitit 2023, AD synon që të vazhdojë bashkëpunimin me projektin e International Narcotics & Law Enforcement Affairs (INL), pranë Ambasadës Amerikane, me ç'rast janë duke u trajnuar 15 ndërmjetësues, të cilët do futen në listën e trajnuesve të AD për fushën e Ndërmjetësimit. Ky trajnim është vazhdimësi e procesit të filluar në mars të vitit 2022, e që pritet të finalizohet në maj të vitit 2023, me certifikimin e pjesëmarrësve që kalojnë me sukses programin trajnues.

Gjithashtu, AD synon që të realizojë edhe Trajnime tjera për Trajnues, në veçanti në fushën e Krimin Kibernetik me projektin e iPROCEEDS, pastaj ToT në fushën e Dhunës në Familje, fushën e Lirisë së Shprehjes si dhe në fushën e konfiskimit dhe sekuestrimit të pasurisë. Numri i sesioneve dhe kohëzgjatja e TIT tjera do të përcaktohet varësisht nga përmbajtja që do të kenë trajnimet përkatëse. Këtyre aktiviteteve i paraprijnë identifikimi i trajnuesve adekuat i cili do të bëhet sipas profilit dhe kompetencës, në bashkëpunim mes AD dhe ekspertëve ndërkombëtarë.

Objektivi V: Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.

Në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorive si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit, Akademia e Drejtësisë do të orientohet në këto objektiva specifike:

- 6.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës
- 6.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë
- 6.3 Avancimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare
- 6.4 Planifikimin institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

6.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

Në funksion të zbatimit më të mirë të programeve trajnuese, Akademia e Drejtësisë do të bashkëpunojë shumë ngushtë me KGJK dhe KPK veçanërisht për trajnimet që dalin si rezultat i vlerësimit të performancës. Vëmendje të veçantë do ti kushtohet koordinimit me kryetarët e gjykatave për trajnimet sipas aplikimit, me prokuroritë gjithashtu si dhe me administratorët për zbatimin e trajnimeve bazike për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithashtu ky bashkëpunim do të fokusohet edhe në zhvillimin e kurrikulave trajnuese sipas nevojave dhe kërkesave të këtyre institucioneve dhe në shkëmbimin e informatave dhe çështjeve tjera në interes të përbashkët. Bazuar në kërkesat që dalin nga Strategjia për sundimin e ligjit, Akademia e Drejtësisë vëmendje të veçantë do ti kushtoj bashkëpunimit me KGJK dhe KPK për zbatimin e masave të përbashkëta të planifikuara për vitin 2023 e gjithashtu edhe masave tjera të cilat kanë qenë të planifikuara edhe para këtij viti por që për arsye të justifikueshme nuk janë realizuar.

6.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet e sistemit të drejtësisë e po ashtu edhe me organizata tjera që kanë në fokus sundimin e ligjit. Përveç bashkëpunimit me KGJK KPK, Gjykata dhe Prokurori siq edhe u potencua më lartë, AD do të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë veçanërisht në zbatimin e strategjive që kanë impakt në punën e gjyqësorit, në koordinimin me Gjykatën Kushtetuese, Avokatin e Popullit, Policinë e Kosovës, Shërbimin Korrektues, Shërbimin Sprovues, Doganën e Kosovës, Agjencinë për mbrojtjen e të dhënave personale, Institutin e Mjekësisë ligjore për zbatimin e programeve praktike në kuadër të trajnimeve fillestare të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar. Vëmendje të veçantë do të kenë edhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet si Akademinë e Sigurisë Publike, Shoqatën e Sigurimeve, Qendrën e trajnimeve dhe burimeve për avokim, Odën e përmbaruesve Privat, Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës “Isa Buletini”, Chechi & Company Consulting, Initiative for Justice and Equality (INJECT), GIZ UNHCR, Organizatat Joqeveritare, Agjencinë për informim dhe Privatesi, me KGJK, KPK, Humanitarian Law, si dhe me shkollën e Maxhistraturës së Shqipërisë.

Këto marrëveshje bashkëpunimi do të konkretizohen më tej me programe të trajnimit të koordinuara dhe të balancuara për përfituesit e Akademisë për të cilat Programi trajnues 2023 do të ofrojë përmbajtjen dhe specifikat e trajnimeve.

6.3 Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare

Gjatë vitit 2023, Akademia synon të jetë në projekte të përbashkëta ndërkombëtare për zhvillim të gjyqësorit e po ashtu edhe nismave të ndryshme rajonale e më gjerë të cilat kanë mision kryesor zhvillimin e praktikave më të mira për ndërtimin e një gjyqësori profesional. Akademia do të mundësojë trajnuesve dhe veçanërisht përfituesve të saj pjesëmarrjen në trajnime, forume, konferenca dhe punëtori të ndryshme në institucione të trajnimit gjyqësor në nivel rajonal si dhe në organizata tjera të cilat kanë në fokus avancimin e trajnimit gjyqësor si dhe sundimin e ligjit.

Gjatë vitit 2023, AD planifikon më shumë se 40 trajnime t'i realizojë në mbështetje dhe bashkëpunim me OPDAT, USAID/Drejtesia Komerciale, WBROLI/CHEMONICS, KE/IPROSEEDS, INL, AIRE Centre, EJTN, IRZ-EUKOJUST, JUFREX, PECK III, UNDP, GIZ, IRZ, UNHCR, EULEX, OSBE, HUMANITARIAN LAW CENTER KOSOVO si dhe iniciativat të mbështetura nga KE, BE dhe të tjera.

Në kuadër të bashkëpunimit me këta mekanizma do të ketë mbështetje në zbatimin e trajnimeve për shpëlarjen e parave, pronësinë intelektuale në fushën e të drejtave të njeriut, drejtësisë për fëmijë, ngritjen e kapaciteteve trajnuese për konfiskimin, financimin e terrorizmit, në risitë sa i përket Kodit të Procedurës penale në çështje e azilit, si dhe në fusha tjera relevante për gjyqësorin.

Objektivi VI: Transparenca dhe marrëdhënia me publikun

Akademia e Drejtësisë është institucion i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë sepse kontribuon në fuqizimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial për të pasur një sistem gjyqësor të pavarur, efikas dhe që gëzon besimin e publikut. Bazuar në këtë parim edhe për veten e saj është kujdesur që të ndërtojë mekanizma që i kontribuojnë marrëdhënies me publikun. Në këtë drejtim, Akademia vazhdon të fuqizoj edhe më tej besimin e publikut duke bërë transparente veprimtarinë dhe aktivitetet e saj përmes web faqes dhe rrjeteve sociale . Edhe gjatë vitit 2023 do të jetë e përkushtuar edhe më tej që ti bëjë publike gjitha aktivitetet e rëndësishme dhe proceset tjera qoftë përmes njoftimeve publike, shpalljeve dhe formave tjera.

Objektivi VII: Rishikimi i akteve nënligjore dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe financa

Ashtu siç është potencuar në këtë plan tek baza ligjore e Akademisë, me hyrjen

në fuqi të ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, do të rishikohen aktet nën ligjore që kanë nevojë për harmonizim me këtë ligji.

Bazuar në planin e punës për vitin 2023 në përmbushje të mandatit ligjore të AD, Departamenti për administratë dhe financa në kuadër të kompetencës ligjore do mbështetet realizmin e suksesshëm e të gjitha aktiviteteve si të paraparë në këtë plan të punës e që përfshinë aktivitete e planifikuara trajnuese në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar dhe Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, aktivitet e planifikuara në kuadër të veprimtarisë hulumtuese dhe botuese, dhe aktivitet tjera mbështetëse. Prioritet i DAF, në fushën e burimeve njerëzore do të jetë fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, plotësimi i pozitave të lira, përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë informative, furnizimet dhe mirëmbajtja e objektit, zhvillimi i planit të prokurimit në bazë të nevojave të AD, dhe planifikimi i buxhetit për vitet në vijim. Në kuadrin e njësisë përmes të cilave operon ky departament do të fokusohet në këto objektiva specifike:

8.1 Zhvillimin, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore;

8.2 Planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit;

8.3 Planifikimin e prokurimit;

8.4 Avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja i infrastrukturës së teknologjisë informative në realizmin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë;

8.5 Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023 dhe

8.1 Zhvillimi, planifikimi dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2023 do të jetë e fokusuar në ofrimin e kushteve më të mira të punës dhe në rritjen e potencialit të tyre. Aktualisht, Akademia e Drejtësisë ka 32 pozita të miratuara prej të cilave 25 janë të plotësuara dhe 7 pozita të tjera janë të lira të cilat do të bëhen konform Ligjit për zyrtarët publik. Me plotësim ndryshimet e ligjit të AD, statusi i të punësuarëve do të rregullohet konform ligjit për zyrtarët publik, dhe në këtë kuadër rregullimi i brendshëm organizativ, sistematizimi i vendeve të punës dhe plotësimi i pozitave vakante do të jetë prioritet. Akademia e Drejtësisë po ashtu do të jetë e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve aktuale njerëzore dhe në këtë drejtim do t'i mundësoj stafit ndjekjen e trajnimeve të ndryshme përmes IKAP por jo vetëm, duke siguruar programe adekuate trajnimi, me qëllim të përfitimit të praktikave më të mira dhe mundësive të reja për zhvillim profesional.

8.2 Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit

Burim kryesor financiar i Akademisë së Drejtësisë është buxheti i Republikës

së Kosovës dhe donacionet e ndryshme. Departamenti për Administratë dhe Financa do të angazhohet në përgatitjen e kërkesave buxhetore në bazë të numrit të aktiviteteve trajnuese të planifikuara duke vlerësuar koston për të gjitha aktivitetet e përfshira në buxhetin. Për vitin 2023, qarkorja buxhetore ka parapare buxhetin në total **892,367** euro, përkundër që kërkesa buxhetore e AD ka qenë **1,436,988**. Pra realizimi i aktiviteteve trajnuese sikurse të planifikuara në kuadër të PTF dhe PTV me buxhetin e aprovuar do jetë pamundur të realizohen, gjë që shumica e aktiviteteve në PTV do jetë e pamundur të realizohen. Realizimi i aktiviteteve trajnuese në kuadër të PTF të cilat janë trajnime të detyrueshme, do të konsumojnë në shumë më të madhe të buxhetit, respektivisht 319,000 euro vetëm nga mallrat dhe shërbimet. Vendosija në objektin e ri ka rrit shpenzimet e qirasë, ngrohjes dhe mirëmbajtjes. Si rezultat i aktiviteteve trajnuese të shumta kanë ngrit shpenzimet e përkthimit si ati simultant ashtu edhe përkthimi i moduleve të trajnimit dhe dokumenteve tjera. Gjatë vitit 2023, planifikoht që realizimi i buxhetit të ekzekutohet në përqindjen maksimale dhe gjithashtu rritja potenciale.

Planifikimit buxhetor do ti paraprijnë takimet dhe vlerësimet brenda njësave organizative të cilat luajnë rol të rëndësishëm në këtë proces. Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet duke respektuar rregullat ligjore në fuqi, të cilat sigurojnë realizimin e planit dhe programit të Akademisë.

8.3 Planifikimi i prokurimit dhe realizimi i suksesshëm me AQP

Bazuar në Ligjin për prokurimin publik, aktivitetet e prokurimit dhe lidhjen e kontratave për Akademinë i realizon AQP. Me këtë ligj ka ndryshuar edhe procesi i realizimit të aktiviteteve të prokurimit. Megjithatë, në fushën e prokurimit, Akademia do të angazhohet në planet për menaxhimin e kontratave dhe zbatimin e tyre në harmoni me legjislacionin në fuqi. Gjatë vitit 2023, Akademia sipas planifikimeve pritet të ketë rreth 9 kontrata për furnizime dhe shërbime të cilat janë të nevojshme në fushën e teknologjisë informative, blerjen e veturave, paisjes me softwer për plaxhiaturë, për furnizim me naftë për ngrohje, furnizim me ushqim, pije për nevojat e trajnimeve si dhe furnizime tjera që janë të nevojshme për procesin e punës në Akademi të Drejtësisë. Ndërkaq edhe rreth 6 kontrata për shërbime të përkthimit, servisim të klimave, akomodim në regjione për nevoja të trajnimeve si dhe shërbime tjera të nevojshme.

8.4 Avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative në realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë

Përdorimi i teknologjisë informative në zbatim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera përmes teknologjisë informative do të jetë një ndër objektivat kryesore në fushën e teknologjisë informative. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i pajisjeve harduerike dhe softuerike që posedon AD-së është një proces i vazhdueshëm i cili kërkon dhe ofron siguri dhe qëndrueshmëri për këto pajisje.

Divizioni i TI do të vazhdoj në ofrimin e përkrahjes së shërbimeve të TIK-ut për përdoruesit e TI-së në realizimin e objektivave të AD-së.

Prioritet do të jetë avancimi bazës së të dhënave për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese si sistem bazë në Akademinë e Drejtësisë, avancimin e modulit për analizë dhe statistika, zhvillimi i kurseve trajnuese në platformën e mësimit në distancë Moodle si dhe blerja e laptopve që do të përdoren ekskluzivisht nga gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së

Për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës për vitin 2023, në Planin e veprimit si në vijim do të përcaktohen qartë: objektivat, njësia përgjegjëse, afatet kohore, buxheti si dhe indikatorët apo rezultatet e arritura. Akademia e Drejtësisë do të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial duke përditësuar këtë plan varësisht nga kërkesat që mund të dalin si pasojë e ndryshimeve legjislativë apo kërkesave tjera nga autoritetet relevante. Mbikëqyrja e zbatimit të Planit të Punës, bëhet përmes procesit të monitorimit i cili realizohet në baza tre mujore. Ky proces mbikëqyrë përmbushjen e indikatorëve si dhe sfidat dhe menaxhimin e rreziqeve.

Në planin më poshtë janë të listuara tetë objektivat madhore të cilat janë në përputhje me nevojat si të pasqyruara me lart në planin e punës. Objektivat janë reale dhe të realizueshme, mirëpo sfide mbetet buxheti për arritjen e objektivave në fjale. AD në kërkesën buxhetore ka kërkuar 1,436,988 euro, ndërsa është aprovuar 892,367 euro, nuk korrespondon me aktivitetet e parapara dhe si të tilla me këtë buxhet do jete i pamundur të realizohen .

Andaj në tabelën si më poshtë janë prezantuar aktivitetet dhe kostoja e tyre, duke u bazuar se buxheti do të rritet në masën e nevojave reale për realizimin e planit të punës 2023.

Planit të performancës për vitin 2023

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së IX si dhe Hartimi dhe zbatimi i programeve për gjyqtarët dhe prokurorët e gjeneratës së X	Zbatimi i trajnimit fillestar për 48 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së IX (trajnimi teorik në AD dhe trajnimi praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë).	Programi i trajnimeve fillestare (PTF)	Janar – Gusht		BKK	Raporti përfundimtar i hartuar për 48 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së IX të trajnuar në modulet sipas Programit trajnues 2022-2023.
	Zbatimi i trajnimit fillestar për 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX (trajnimi teorik në Akademi të Drejtësisë dhe trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit prokurorë)	(PTF)	Janar – Gusht			Raporti përfundimtar i hartuar për 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX të trajnuar në modulet sipas Programit trajnues 2022-2023.
	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e X të gjyqtarëve prokurorëve rinj, gjegjësisht 37 gjyqtarëve dhe 22 prokuroreve te rinje ²	(PTF)	Janar- Dhjetor			Gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar të trajnuar në modulet përkatëse sipas programit trajnues për gjeneratën e X

² Zhvillimi dhe fillimi i zbatimit te programit te trajnimit fillestare varet nga përfundimi i suksesshëm i procesit qe momentalisht eshte duke u zhvilluar per rekrutim te 37 gjyqtareve dhe 22 prokuroreve te rinjë nga KGJK dhe KPK,

				319,778		
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë liigjor	Trajnimet nga lëmia Penale	(PTV)				9 trajnime, me pjesëmarrje deri 90 gjyqtarë, 40 prokuror, 20 bashkëpunëtor profesional
	Trajnime nga Programet e Specializuara ne fushën Penale	(PTV)	Janar-Dhjetor		BKK buxheti	9 trajnime, me pjesëmarrje deri 50 gjyqtarë, 20 prokurorë, 10 bashkëpunëtorë profesional dhe ekspert të PSRK-së të trajnuar
	Trajnimet nga lëmia Civile	(PTV)	Janar-Dhjetor			15 trajnime, me pjesëmarrje deri 150 gjyqtarë, 30 bashkëpunëtor profesional
	Trajnimet nga lëmia e drejtësisë për fëmijë	(PTV)	Janar-Dhjetor			10 trajnime, me pjesëmarrje deri 50 gjyqtar, 20 prokuror, 20 bashkëpunëtor profesionale, 10 shërbim sproves, 5 zyrtar policor

	Trajnimet nga lëmia Komerçiale	PTV)	Janar-Dhjetor			9 trajnime me pjesëmarrje deri 54 gjyqtarë, 15 bashkëpunëtor profesional, 2 prokuror dhe 2 zyrtare policor, 3 përmbarues privat
	Trajnimet nga drejtësia kushtetuese, adminisitrative kundërvajtëse dhe Dhoma e posqme e Gjykatës Supreme	PTV)	Janar-Dhjetor			14 trajnime me pjesëmarrje deri 70 gjyqtar, 10 bashkëpunëtor profesional, 10 zyrtar të ministrisë së punëve të brendshme
	Trajnimet për KEDNJ	PTV)	Janar-Dhjetor			11 trajnime me pjesëmarrje deri 45 gjyqtarë, 35 prokuror, 22 bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor, 11 avokat shtetëror, 5 zyrtar te ndihmës juridike falas
	Trajnimet nga e Drejta e BE-së dhe e drejta ndërkombëtar	PTV)	Janar-Dhjetor			2 trajnime me pjesëmarrës deri 8 gjyqtar, 4 prokuror, 4 bashkautor profesional dhe 4 zyrtar te ministrisë se drejtësisë
	Trajnimet nga kompetenca interdisciplinare	PTV)	Janar-Dhjetor			4 trajnime me pjesëmarrje deri 20 gjyqtar, 10 prokuror, 5 bashkëpunëtor profesional dhe zyrtare ligjor,

	Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK	(PTV)	Janar-Dhjetor			6 trajnime me pjesëmarrje deri ne 30 prokuror Prokurorë të trajnuar për trajnimet e detyrueshme ³
	Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive	(PTV)	Janar-Dhjetor			Deri në 130 bashkëpunëtorë profesional dhe 30 zyrtarë ligjor të trajnuar
	Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	(PTV)	Janar-Dhjetor			Deri 75 staf administrativ duke përfshirë Administratorë, ndihmës administratorë, shef ZML-së, referentë, zyrtarë të statistikave, sekretarë juridikë, arkivistë, zyrtarë për komunikim dhe media me publikun të gjykatave dhe prokurorive si dhe zyrtarë ligjor dhe zyrtarë nga njësi të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorive sekretarive të KGJK-së dhe KPK-së të trajnuar

³ Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajnuar varet nga vlerësimi i performances dhe nga kërkesat e KGJK dhe KPK.

	Ofrimi dhe zbatimi i trajnimeve sipas kërkesave të institucioneve të profesioneve të lira	(PTV)		NA		Përmbartues privat, mbrojtës të viktimave, zyrtarë të ANJF si dhe zyrtarë të OJQ-ve që ofrojnë ndihmë juridike falas të trajnuar
	Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	PTV si dhe njësi e TI-së	Janar - Dhjetor	285,712		1 kurse i ri dhe 1 që do të editohet dhe plotësohet për gjyqtarë, prokurorë, profesionistë tjerë të si dhe 40 përkthyes/interpretë gjyqësor
3.Rritja e kapaciteteve analitike dhe hulumtuese si dhe e veprimtarisë botuese	Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2024	Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)			BKK	Raporti me analizën dhe vlerësimin e nevojave trajnuese i hartuar
	Hulumtimi i praktikës gjyqësore	PHP	Janar-dhjetor			Raporti me analizën e praktikës gjyqësore në çështjet penale
	Zhvillimi i veprimtarisë botuese	PHP	Janar dhjetor			Procedurat për standardet e publikimit të miratuara
	Planifikimin institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese	AD	Janar-Dhjetor	62,422		Raportet të hartuara për mekanizmat përkatës

5. Avancimi i mëtejshëm i metodologjisë trajnuese	Zhvillimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë	AD	Janar-dhjetor			Programi i trajnimit për trajnues i hartuar
	Zbatimi i trajnimit për trajnues	PTV	Janar - Dhjetor	24,410		5 trajnime për trajnues në fushën e ndërmjetësit, konfiskimi, krimi kibernetikë, dhunë në familje dhe për lirin e shprehjes dhe medias deri 25 Gjyqtarë, 10 prokurorë si dhe 10 përfitues tjerë sipas ligjit të trajnuar
5. Ngritja e transparencës dhe marrëdhënia me publikun	Ofrimi i qasjes për palët e interesit	AD	Janar-Dhjetor			Rreth 40 postime në linkedin, 120 në facebook si dhe në njoftimet dhe raportet në web sipas aktiviteteve të planifikuara qoftë në Programin trajnues ashtu edhe në aktivitete tjera në funksion të procesit të punës në AD
6. Rishikimi i akteve nënligjore dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve	Rishikimi, zhvillimi dhe amandamenti i akteve të brendshme	AD	Janar – dhjetore			7 akte të brendshme të rishikuara dhe amandamentuara

administrative dhe financa	Zhvillimin, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore	Departamenti për Administratë dhe Financa (DAF)	Janar-Dhjetor		BKK	Organizmi dhe sistematizimi i brendshëm Plotësimi i pozitave të lira Numri i stafit të AD-së i trajnuar
	Planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit në pajtim me rregullat ligjore në fuqi	(DAF)	Mars-Tetor			KASH-Buxheti 2024-2026 i hartuar dhe e aprovuar nga KD
	Planifikimin e prokurimit dhe menaxhimin e drejtë të kontratave	(DAF)	Janar-Dhjetor			Plani i hartuar dhe i zbatuar
	Përdorimi i teknologjisë informative në realizmin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë	(DAF)	Janar-Dhjetor	106,800		Lista e pajisjeve funksionale
	Zhvillimi specifikimit teknik për përditësimin e bazës së të dhënave	DAF ne bashkëpunim me ekspertet nga EUKOJUST				Raporti final i specifikimit teknik për zhvillimi dhe avancimi i bazës së të dhënave
	Zhvillimi specifikimit teknik për furnizim me laptop	DAF dhe AQP	Janar			Furnizimi me 60 laptop
	Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023	(DAF)	Janar-Dhjetor			Furnizimet dhe shërbimet e pranuar si dhe raporti i

Buxheti sipas kërkesës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2023 dhe sipas qarkores buxhetore 2023/2 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;

Kategoria	Qarkorja Buxhetore 2023/02 - MFPT	Kërkesa Buxhetore 2023	Difrenca Kërkesa Buxhetore 2022 - Qarkorja Buxhetore 2023/02 - MFPT
Paga dhe Meditje	244,867	365,751	(120,884)
Mallra dhe sherbime	435,000	853,737	(418,737)
Shpenzime Komunale	16,500	20,700	(4,200)
Shpenzime Kapitale	196,000	196,800	(800)
Total Buxheti	892,367	1,436,988	(544,621)

9. Sfidat dhe rreziqet

Realizimi i këtij plani përmban sfida dhe rreziqe, ndër të cilat theksojmë:

- Procesi i plotësimit ndryshimit të Ligji për Akademinë e Drejtësisë konform nevojave;
- Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara për realizimin e të gjitha aktiviteteve në programet e trajnimit;
- Buxheti jo i mjaftueshëm për inventarin dhe funksionalizmin e plote të objektit të ri të AD-së;
- Stafi i pamjaftueshëm për zbatimin e aktiviteteve hulumtuese dhe kërkimore, komunikimit dhe marrëdhënies me publikun;
- Kërkesat e shumta të projekteve me donatorë për trajnime ad-hoc që nuk janë të planifikuara në Programin Trajnues;
- Sigurimi i pjesëmarrësve në trajnimet ad-hoc;

- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
- Zhvillimi programit të përhershëm për trajnues dhe ngritja e kapaciteteve të trajnuesve;

Akademia e Drejtësisë do të hartoj një regjistër të veçantë ku do të parashihen të gjitha rreziqet e mundshme, shkalla e rrezikut, personat përgjegjës për adresimin e këtyre rreziqeve si dhe specifika tjera siç përcaktohet me të gjitha standardet relevante për monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve.

10. Përfundimi

Plani i punës dhe i Performancës për vitin 2023 është dizajnuar përshtatshëm me rrethanat e reja në të cilin janë përcaktuar në detaje realizimi i aktiviteteve nga programet përmes të cilave ushtron veprimtarinë Akademia e Drejtësisë si dhe njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre. Stafi i Akademisë do të angazhohet në përmbushjen e këtij plani duke i marrë në konsideratë veprimet dhe afatet e përcaktuara për çdo aktivitetet të paraparë.